



Ministrja Ekonomi prezanton projektbuxhetin e MZHETTS për vitin 2017: Mbështet rritjen e qëndrueshme ekonomike



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, prezantoi projektbuxhetin e MZHETTS për vitin 2017 në komisionin parlamentar të Veprimtarive Prodhuese dhe Mjedisin. Në fjalën e saj para deputetëve, ministrja Ekonomi vlerësoi projektbuxhetin si një hap të rëndësishëm në vazhdimësinë e rritjes ekonomike pozitive dhe të reformave. “Buxheti 2017 është buxheti që mbështet rritjen e qëndrueshme ekonomike, financimin e reformave dhe rritjen e pagave dhe pensioneve”,- tha Ekonomi. Vitin e ardhshëm, sipas ministres, rritja përshpejtohet në 3.8%, ose rreth katërfishi i asaj që ishte në vitin 2013. Ministrja informoi se projektbuxheti i vitit 2017 për Ministrinë e Ekonomisë është 2.051 milionë lekë dhe objektivi i rëndësishëm i këtij programi buxhetor do të jetë rritja e aftësisë konkurruese të biznesit, mbështetja për integrimin e tij drejt tregut evropian dhe me gjerë, duke nxitur përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit dhe investimeve, në rritjen e kapaciteteve inovative teknologjike, prodhuese dhe menaxheriale. Ndërsa evidentoi suksesin e arritur nga Shqipëria në renditjen e raportit të Bankës Botërore “Doing Business”, ku Shqipëria për herë të parë renditet në vendin e 58-të me një përmirësim prej 32 vendesh krahasuar me vitin e kaluar, ministrja Ekonomi e konsideroi atë si një “inkurajim për të thelluar me tej punën në ndërmarrjen e reformave që ndikojnë në lehtësitë e të bërit biznes dhe në përmirësimin e klimës së investimeve”. E në këtë kontekst, për vitin e ardhshëm, në fokus të punës do të jetë reforma e derregullimit që lidhet me reduktimin e barrierave administrative në licencim/leje, ku tashmë ka nisur puna për të analizuar lejet dhe licencat duke synuar reduktimin e tyre si dhe shkurtimin e afatit të lëshimit të tyre. Reformë tjetër e rëndësishme e parashikuar për vitin 2017 do të jetë reforma në fushën e autorizimeve që ka në fokus eliminimin e kërkesave procedurale të panevojshme dhe akteve të panevojshme si dhe thjeshtimin e procedurave dhe afateve të autorizimeve. Në përfundim të prezantimit, ministrja Ekonomi tha se buxheti i vitit 2017 është buxheti që do të garantojë realizimin me sukses të mbështetjes së sipërmarrjes, tregtisë dhe turizmit, por që pa dyshim do të koordinohet edhe me ndërhyrjet e tjera të realizuara nga ministritë përkatëse për 2013 – 2017, si dhe në finalizimin me sukses të të gjithë projekteve të nisura e që priten të përfundojnë në vitin që vjen.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-e-zhvillimit-ekonomik-turizmit-tregtise-dhe-sipermarrjes-znj-milva-ekonomi-prezantoi-ne-komisionin-parlamentar-te-veprimtarive-prodhuese-projektbuxhetin-per-vitin-2017&page=1>

Këshilli i Investimeve diskuton mbi Rimbursimin e TVSH, rekomandime për përmirësimin e klimës së biznesit



Nën drejtimin e Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, u mbajt mbledhja e radhës e Këshillit të Investimeve, ku tema e diskutimit ishte “Mbi Rimbursimin e TVSH”-së. Të pranishëm në mbledhje ishin përfaqësues nga zyra e Bankës Botërore në Shqipëri, zyra e delegacionit të Komisioni European, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, zv.ministri i Financave, Ervin Mete, përfaqësues nga drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, biznesi, etj. Ministrja Ekonomi theksoi se “kjo ishte mbledhja e tetë e radhës dhe siç është bërë tashmë zakon tashmë, këshilli diskuton mbi tema që ka rënë dakord më parë. Mbledhja e sotme do të fokusohet në një analizë e situatës së rimbursimit të TVSH-së”, tha ajo. Ministrja Ekonomi informoi anëtarët e Këshillit të Investimeve me përmirësimin e procedurave tatimore, ndryshime ligjore që tashmë janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Ministrja tha se numri i procedurave të lehtësuara për biznesin ka shkuar në 37. Gjatë diskutimit, Ministrja Ekonomi tha se duhet të inkurajohet biznesi që të aplikojë online për rimbursimin e TVSH dhe se komunikimi me biznesin ka filluar të tregojë se cilat janë problemet më shqetësuese për biznesin. “Ky komunikimi duhet të mbahet i gjallë dhe forumet e ngritura tashmë, si Këshilli i Investimeve apo KEK, duhet të përdoren pikërisht për këtë. Fakti që me ndryshimet në ligjin e procedurave tatimore përmirësojmë 37 procedura nga ato që vetë biznesi ka kërkuar, tregon se komunikimi me biznesin ka funksionuar dhe ka dhënë rezultate”, tha Ministrja. Këshilli i Investimeve vijoi mbledhjen me prezantimin e një analize që është bërë mbi situatën e rimbursimit të TVSH, analizë që përveç gjetjeve shoqërohet edhe me disa rekomandime përkatëse, të cilat do t’i propozohen qeverisë për ndryshimin e situatës. Rekomandimet e Këshillit të Investimeve konsistojnë në respektimin e afateve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi, lehtësimin e barrës procedurale për administratën tatimore dhe bizneset, bërjen transparente të procedurave të brendshme në trajtimin e rasteve të rimbursimit të TVSH, strukturim i informacionit të DPT nëpërmjet një faqe interaktive për biznesin në funksion të edukimit fiskal të tatimpaguesve dhe rritjes së transparencës, reforma anti informalitet të strukturohet më tej, duke u forcuar përpjekjet për zbatimin e masave, etj. Diskutimet në mbledhjen e Këshillit u fokusuan në tre çështje kryesore, afatet e parashikuara në kuadrin ligjor, kontrollet dhe funksionimit e Riskut, informimi i biznesit.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/keshilli-i-investimeve-diskuton-mbi-rimbursimin-e-tvsh-rekomandime-per-permiresimin-e-klimes-se-biznesit&page=1>

Forumi i Akademisë së Shkencave, diskutohet perspektiva e zhvillimit ekonomik



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, mori pjesë në Forumin Publik të zhvilluar nga Akademia e Shkencave. Ky forum u organizua në kuadër të angazhimit të Akademisë në përgatitjen e dokumentit shkencor të politikave “Karta e Gjelbër: Shqipëria 2025. Rimodelimi i zhvillimit dhe kontekstet lokale”, mbi projektimin e zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë gjatë dhjetëvjeçarit 2016-2025. Në fjalën e saj, Ministrja vuri theksin në ndryshimin e qasjes ndaj zhvillimit ekonomik, duke u bazuar te burimet natyrore, kapitali njerëzor dhe burimet e jashtme. Gjithashtu, ajo bëri një prezantim të situatës ekonomike të vendit dhe objektivave të qeverisë shqiptare për të ardhmen. “Në Shqipëri rritja ekonomike ka qenë e ngadaltë, por e qëndrueshme, ndërkohë që pritet të ketë një shpërthim të ri. Rritja ekonomike është gjykuar që duhet të vijë nga dy burime: konsumi i brendshëm i popullatës dhe investimet e brendshme. Të gjitha shifrat tregojnë se ka përmirësim, edhe investimet në makineri dhe pajisje, po t’i referohemi shifrave të doganës janë në rritje me 17%”, tha Ministrja. Sipas znj. Ekonomi, zhvillimi i mëtejshëm ekonomik i vendit do të bëhet i mundur nëpërmjet përdorimit të burimeve natyrore dhe vazhdimi i luftës kundër informalitetit.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/fjala-e-ministres-se-zhvillimit-ekonomik-turizmit-tregtise-dhe-sipermarrjes-znj-milva-ekonomi-ne-forumin-publik-te-akademise-se-shkencave&page=1>

Ministrja Ekonomi inkurajon Konsujt e Nderit të tërheqin investime në turizëm



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Znj. Milva Ekonomi, ishte e pranishme në tryezën e rrumbullakët “Nxitja e Turizmit dhe Kulturës si katalizatorë të Zhvillimit Ekonomik- Roli i Konsujve të Nderit”, e cila u organizua nga Shoqata “Konsujt e Nderit në Shqipëri”. Të pranishëm në këtë tryezë ishin Ministrja e Kulturës, Znj. Mirela Kumbaro, Presidenti i Shoqatës Z. Ylli Ndroqi, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, z. Johann Sattler, Ambasadori i Sllovakisë në Shqipëri, z. Milan Ciganik, Konsujt e Nderit të Shqipërisë në botë, përfaqësues të biznesit, etj. Në fjalën e saj, Ministrja Ekonomi bëri një prezantim të zhvillimit të sektorit të turizmit në Shqipëri, sidomos gjatë vitit 2016, arritjeve të sektorit dhe synimet për vitin e ardhshëm, si dhe theksoi rolin e madh që mund të luajnë Konsujt e Nderit në promovimin e mëtejshëm të Shqipërisë turistike dhe thithjen e investimeve të huaja për këtë sektor, por jo vetëm.

“MZHETTS nxit të gjithë ata që kanë mundësi për të sjellë investitorë, në zona me pronësi shtetërore, për të zhvilluar struktura akomoduese, projekte që kanë të bëjnë me mirë menaxhimin e brigjeve tona detare apo dhe projekte që kanë të bëjnë me inovacione në fushën e turizmit”, tha Ministria.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/fjala-e-ministres-ne-konferencen-e-konsujve-te-nderit&page=1>

“Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit të Bregdetit Jugor”



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, së bashku me ministren e Zhvillimit Urban, znj. Eglantina Gjermeni dhe drejtorin e GIZ, z. Hans-Jurgen Cassens, mori pjesë në takimin e Tretë Koordinues (3rd Steering Committee), në kuadër të projektit “Zhvillimi i Integruar dhe i Qëndrueshëm i Rajonit të Bregdetit Jugor”. Ministrja Ekonomi vlerësoi sinergjinë dhe koordinimin e mirë me Ministrinë e Zhvillimit Urban përsa i përket bashkëpunimit në kuadër të zhvillimit të turizmit rajonal apo shkëmbimit të ideve në shërbim të turizmit. Gjatë fjalës së saj, Ekonomi e vuri theksin tek realizimi i një inventari ku të regjistrohen të gjitha produktet turistike që ofron jo vetëm jugu, por të gjitha vendet ku bëhet turizëm në Shqipëri, pasi ky inventar do të shërbejë për turistët vendas dhe të huaj në njohjen e ofertave turistike. Gjithashtu, ministrja Ekonomi e konsideroi shumë të rëndësishëm pjesën e promovimit dhe zhvillimit të produkteve turistike nëpërmjet qendrave informuese apo të quajtura ndryshe “Info point”. Projekti, tha më tej ministrja, duhet të fokusohet tek teknologjia inovative edhe tek trajnimi i njerëzve në lidhje me shërbimin, pasi duhet të sigurohet një shërbim sa më i mirë tek turisti që zgjedh vendin tonë për të vizituar dhe pushuar. “Së bashku me Ministrinë e Kulturës duhet të promovojmë sa më shumë trashëgiminë kulturore dhe historike, pasi jugu ka një territor të pasur me vlera arkeologjike”, tha ministrja Ekonomi..

Shkodër, inaugurohet fabrika më e madhe e duhanit në Ballkan



Një investim i rëndësishëm u inagurua dje në Gur të Zi (Shkodër), duke u bërë fabrika më e madhe e grumbullimit, përpunimit dhe paketimit të duhanit në Ballkan. Falë një investimi të konsiderueshëm, linja e përpunimit dhe paketimit është e teknologjisë së fundit gjermane u vendos në një zonë që njihet për kultivimin e duhanit. Kapaciteti i kësaj linje arrin në 1.000 kilogram duhan përpunim/orë. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, e cila ishte e pranishme në këtë ceremoni, vlerësoi kompaninë “IGLA shpk” për këtë investim serioz ku do të punësohen rreth 20 punëtorë dhe që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë e zonës përreth. Një zonë tradicionalisht e njohur për kultivimin e duhanit do të ketë tashmë një fabrikë moderne me një teknologji bashkëkohore. Ky investim do të ndikojë në rritjen e kapaciteteve grumbulluese dhe përpunuese, ku përfutuese do të jetë edhe zona e Cërrikut, mbasi një pjesë e duhanit që do të përpunohet në këtë fabrikë do të prodhohet në këtë zonë. Kjo kompani me eksperiencë të mëparshme në këtë industri, në prodhimin e letrës së cigares, e përmbyll tashmë ciklin prodhues deri në shitje duke ofruar llojshmëri të gjerë dhe specialitete të duhaneve të zgjedhura: puro, cigare, filtra, si dhe aksesore për duhan të dredhur. Tregu në të cilën operon kompania “IGLA Shpk është e fokusuar sidomos në atë Italian, por gjithashtu prej vitesh është duke u punuar intensivisht edhe me tregje të tjera europiane sikurse janë: Republika Çeke, Sllovakia, Kroacia, Kosova, Bullgaria, Serbia, Belgjika, Gjermania, Franca.

MZHETTS organizon trajnimin për Ndhmën Shtetërore në Bashkinë e Elbasanit



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), Sektori i Kontrollit të Ndhmës Shtetërore, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në fushën e ndihmës shtetërore dhe me mbështetjen e projektit të financuar nga IPA 2014, organizoi në datën 23 Nëntor trajnimin me nëpunës në Bashkinë Elbasan me temë: “Kuptimi dhe parimet kryesore të kontrollit të ndihmës shtetërore”. Objektivi kryesor i trajnimit ishte përmirësimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të nëpunësve, pjesë e autoriteteve shtetërore që janë dhënë potencial të ndihmës shtetërore, për të kuptuar dhe zbatuar rregullat e ndihmës shtetërore, përfshirë pasojat e moszbatimit, si dhe procedurat ligjore që organet e pushtetit qendror dhe vendor duhet të ndjekin për të marrë vlerësimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore për çdo veprimtari që sjell implikime të ndihmës shtetërore. Në trajnim u prezantua politika e ndihmës shtetërore në vend, se si funksionon dhe cilat janë organet ligjore kontrolluese të ndihmës shtetërore. Më pas, z. Sigitas Cemnolonksi, eksperti i kontraktuar shpjegoi konceptin dhe parimet themelore të ndihmës shtetërore, duke ofruar eksperiencën e vendeve të Bashkimit Europian. Pjesëmarrësit diskutuan dhe ngritën pyetje në lidhje me procedurat e njoftimit dhe kontrollit të skemave të ndihmës shtetërore, me qëllim njohjen dhe respektimin e kërkesave ligjore të ndihmës shtetërore gjatë punë së tyre të përditshme. Në përfundim të trajnimit u diskutua për hapat e mëtejshëm për përmirësimin e bashkëpunimit.

AIDA, tre kompani përfitojnë nga Fondi i Ekonomisë Kreative



Komisioni i Aprovimit të Grantit (KAG) në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve zhvilloi mbledhjen e tij të radhës në datën 22 Nëntor, në ambientet e AIDA-s. Në këtë mbledhje, Komisioni shqyrtoi dosjet aplikuese të paraqitura pranë Sportelit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME). Në total u paraqitën tre kompani aplikuese. Në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 20.01.2016, dhe kriteret e rregullores së Fondit të Ekonomisë Kreative (Artizanatit), Komisioni i Aprovimit të Grantit miratoi dosjet si më poshtë: Asllan Baca, Shkodër, punime artizanale me metal; Valbona Elezi, Durrës, punimet me grep, qëndisje të ndryshme me dorë; Brixhilda Prendi, Tiranë, qëndisje të ndryshme me dorë

Ditë informuese mbi Rrjetin European të Ndërmarrjeve me bizneset e Shkodrës



Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zhvilloi një tryezë me biznesin e qarkut të Shkodrës me temë: “Ditë Informuese mbi Rrjetin European të Ndërmarrjeve. Kryefjala e këtyre takimeve ishte informimi i biznesit të këtij qarku mbi mbështetjen që rrjeti evropian i ndërmarrjeve sjell për SME-të shqiptare në rrugën drejt tregjeve të reja dhe në përmbushjen e objektivave të tyre për t’u inovuar dhe zhvilluar ndërkombëtarisht. Këtë prezantim e ofroi për të pranishmit znj. Migena Muslli, në cilësinë e menaxheres së projektit EEN Albania. Prezantimi ndihmoi të pranishmit për të kuptuar si funksionojnë partneritetet ndërkombëtare, si asistojnë ekspertët e rrjetit me informacione specifike, llojet e biznesit që përmbushin kërkesat për të përfituar nga partneritetet. Kompanitë shqiptare të interesuara duhet të plotësojnë formatet dhe pastaj ti paraqesin tek AIDA e cila i publikon ato në data bazën e rrjetit duke i bërë disponibël për të përfituar nga shërbimet e EEN. Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve është një instrument i rëndësishëm në strategjinë e BE-së, i cili sjell së bashku rreth 600 organizata mbështetëse të biznesit nga më shumë se 60 vende të botës, me qëllim mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe mbi mundësinë e të bërit biznesit në Tregun Unik të BE-së.



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania

Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55

E-mail: zmp@ekonomia.gov.al

Web: www.ekonomia.gov.al

